



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____ prot

Gramsh, më 19/08/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 19.08.2019

Për: Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë- “Përparimi/G ”shpk & “Blerimi “shpk

Adresa: Lagjia “Sporti”, Pall.8/287, kati përdhe & Fshati Mjekës,, NJA Shirgjan, Rruga Elbasan-Cërrik, km.4 , Elbasan.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozime”, me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-30561-07-17-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Ndërtim ure pasarelë fshati Velak, NJA Pishaj” me afat 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 22/07/ 2019 [Nr. 29]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

* * *

1. **Shoqëria- “B-93 ”sh.p.k** me nr.Nipti J62903508R me vlerë të ofertës 5 785 783,80 (pesëmilionë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetëdhjetë) lekë, pa TVSH.
2. **Shoqëria- “Egland ” sh.p.k** me nr.Nipti J96829419D me vlerë të ofertës (6 252 950 (gjashtëmilionë e dyqind e pesëdhjetë e dymijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë, pa TVSH
3. **BOE-** “Përparimi/G ”sh.p.k & “Blerimi “sh.p.k me nr.Nipti J66702835G & J62903384G me vlerë të ofertës 6 571 020 (gjashtëmilionë e pesëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e njëzetë) lekë, pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

1. **Shoqëria- “B-93 ” sh.p.k, përkatësisht për arsyet :**

- Shoqëria “B 93 “ shpk nuk ka dorëzuar mostrat si dhe nuk është pajisur me vërtetim për dorëzimin e tyre në kundërshtim me kriteret e vecanta të kualifikimit ku kërkohej „Operatori ekonomik duhet të sjelle 3 ditë para zhvillimit të tenderit në orën 10:00 pranë Autoritetit Kontraktor. Operatori, interesuar duhet të sjelle mostrat e dhe do të pajisen me vërtetim nga insitucioni (mosparaqitja është kusht skualifikimi) si me poshte:
 1. Kavo celiku Φ 32 (6x37)
 2. Kavo celiku Φ 30 (6x37)
 3. Kavo celiku Φ 20 (6x37)
- Shoqëria „B 93“ shpk nuk ka dorëzuar analizat teknike të cmimeve në kundërshtim me

kriteret e vecanta të kualifikimit në të cilën është kërkuar - *Per zerat e preventivit te cilet nuk jane pjese e manualit Teknik te Çmimeve te paraqiten analizat teknike te cmimeve sipas VKM viti 2015. Dhe per cdo ze te preventivit te paraqiten analizat teknike te cmimeve*

- Nuk përmbush kriterin për një inxhiner të pajisur me certifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe ndihmën e parë në kundërshtim me "c" të kriterëve të vecanta të Kualifikimit,
 - Nuk përmbush kriterin për 5 punonjës montatorë të pajisur me kartela të sigurimit teknik në kundërshtim me pikën "E" të kriterëve të vecanta të Kualifikimit. Ka dorëzuar kontratë pune dhe kartelë e sigurimit teknik vetëm për 2 montatorë .Në kriteret e kualifikimit është kërkuar *E)Operatori ekonomik duhet te kete minimum 5 punonjes montator dhe 1 punonjes saldator te pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, te leshurara nga autoriteti perkates.*
 - Nuk përmbush kriterin për 4(katër) kamionë, pasi në shtojcën 10'Mbi disponimin e makinerive" ka deklaruar vetëm 3(tre) kamionë.Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar pavarësisht se nuk është deklaruar te shtojca 10,kamioni me targa AA872CE është me kapacitet mbajtës nën 10 ton, në kundërshtim me pikën "G" të kriterëve të vecanta të Kualifikimit,
 - Nuk ka dorëzuar dokumentacion si dhe nuk është deklaruar në shtojcën 10'Mbi disponimin e makinerive" për 2 copë Parango me zinxhire me kapacitet min. 6 ton, në kundërshtim me pikën "G" të kriterëve të vecanta të Kualifikimit,
 - Nuk ka deklaruar në shtojcën 10'Mbi disponimin e makinerive" për një aparat prerës për plazma si dhe një motosldatice në kundërshtim me pikën "G" të kriterëve të vecanta të Kualifikimit,
 - Nuk është dorëzuar Autorizim i prodhuesit/distributorit/ve per mallrat e ofertuar si dhe Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve per mallrat e ofertuar në kundërshtim me pikën "C" të kriterëve të vecanta të Kualifikimit,në të cilën është kërkuar:***Operatori ekonomik duhet te paraqese:*** 1. *Autorizim te prodhuesit/distributorit/ve per mallrat e ofertuar ne perberje te preventivit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*
2. *Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve per mallrat e ofertuar, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.*
- Në shtojcën 10 "Mbi kontratat e lidhura dhe /ose në proces " nuk ka deklaruar asnjë kontratë ,ndërsa nga verifikimet rezulton se në BNJP nr.30 datë 29.07.2019 ky operator ekonomik ka nënshkruar kontratë me bashkinë Tiranë më datë 19.07.2019 me objekt " Rikonstruksion i bibliotekës së qytetit njësia 6".

2. Shoqëria- "Egland " sh.p.k, përkatësisht për arsyet :

- Shoqeria "Egland " shpk nuk ka dorezuar mostrat si dhe nuk është pajisur me vërtetim për dorëzimin e tyre në kundërshtim me kriteret e vecanta të kualifikimit ku kerkohet „*Operatori ekonomik duhet te sjelle 3 ditë para zhvillimit të tenderit ne oren 10:00 prane Autoritetit Kontraktor Operatori, interesua duhet të sjelle mostrat e dhe do te pajisen me vertetim nga insitucioni (mosparaqitja eshte kusht skualifikimi)si me poshte:*

1. Kavo celiku Φ 32 (6x37)

2. Kavo celiku Φ 30 (6x37)

3. Kavo celiku Φ 20 (6x37)

- Shoqëria „Egland“ shpk nuk ka dorëzuar analizat teknike të cmimeve në kundërshtim me kriteret e vecanta të kualifikimit në të cilën është kërkuar - *Per zerat e preventivit te cilet nuk jane pjese e manualit Teknik te Çmimeve te paraqiten analizat teknike te cmimeve sipas VKM viti 2015. Dhe per cdo ze te preventivit te paraqiten analizat teknike te cmimeve.*
- *Nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme pasi në kërkesat për kualifikim Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, ka kërkuar:*
 - *Formulari i vleresimit sipas shtojces 9, si vërtetime të lëshuara nga një ent publik .*
 - *Kontraten/ t.*
 - *Situacionet pjesor edhe perfundimtare*
 - *Faturat tatimore perkatese per cdo situacion*
 - *Akt kolaudimi*
 - *Certifikata e marrjes ne dorezim te leshuar nga autoriteti kontraktor.*

Operatori ekonomik “Egland” shpk ka dorëzuar për të provuar dëshminë për punë të ngjashme ka dorëzuar kontratën e sipërmarrjes nr.592/6 prot datë 12.12.2016 me object “Riparimi në argjinaturën e Gjoricës (e poshtme + e sipërme) ,por nuk ka dorëzuar certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve.Ka dorëzuar një deklaratë në të cilën deklaroi se *se disa nga objektet qe ju kemi paraqitur jane brenda afatit te garancise se punimeve dhe se certifikata perfundimtare merret pas mbarimit te ketij afati, kurse certifikaten e marrjes ne dorezim te perkoshme nuk aplikohet si procedure nga autoriteteve kontraktore te ketyre objekteve* “por referuar datës së lidhjes së kontratës 12.12.2016 dhe afatit të përfundimit datë 30.12.2016, si dhe nenit 8 pika 8.5 të kontratës e cila përcakton afatin 1 vit si periudhë garancie,që do të thotë se më datë 30.12.2017 ka përfunduar periudha e garancisë së difekteve ,dhe si e tillë duhej paraqitur certifikata e marrjes në dorëzim e punimeve,.

Gjithashtu për të provuar përvojën e mëparshme ka dorëzuar kontratën e sipërmarrjes nr.2487 datë 28.06.2017 me Objekt “Sistemim i përroit Zenke,NJA Gjoricë,bashkia Bulqizë” por nuk ka dorëzuar për këtë objekt Formularin e vlerësimit sipas shtojcës 9 si dhe faturat tatimore për cdo situacion,në kundërshtim me Kriteret e Vecanta të kualifikimit.

Sa më sipër ky operator ekonomik nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme.

- Nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën “ c” të kriterëve të kualifikimit në të cilën përcaktohet se “ *Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë minimalisht për 6 muajt e fundit : Inxhinierë te kualifikuar me certifikata si me poshte:c)Çertifikatë per Mbrojtjen ndaj Zjarrit dhe Ndihtmen e Pare (minimumi 1 person).*

Ky operator ekonomik ka dorëzuar një kontratë shërbimi me një ekspert zjarrfikës e cila nuk është lidhur para noterit e si e tillë nuk mund të ketë vlerë ligjore.Përvec kësaj në kriteret e kualifikimit është kërkuar që një prej inxhinierëve të stafit të jetë i kualifikuar me certifikatë të tillë dhe të jetë në listëpagesat e shoqërisë,dhe nuk është parashikuar kontratë shërbimi me ekspert te jashtem.Sa më lart ky kriter konsiderohet i papërmbushur pasi të dyja kontratat janë dorëzuar me mangësi dokumentacioni.

- Mjeku i shoqërisë i deklaruar nuk figuron në listë pagesat e shoqërisë , në kundërshtim kjo me Kriteret e Vecanta të kualifikimit.

Nuk ka pasqyruar në shtojcën 9 “Mbi deklarimin e makinerive”,pajisjet teknike si:motosaldatrice,aparate prerës me plazma, minifadromë me goma ,parafango me zinxhirë

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë** Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë- “Përparimi/G ”shpk & “Blerimi “shpk , me adresë Lagjia “Sporti”,Pall.8/287,kati përdhe &Fshati Mjekës,,NJA Shirgjan, Rruga Elbasan-Cërrik,km.4 ,Elbasan , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **6 571 020 (gjashtëmilionë e pesëqind e shtatëdhjetë e njëmijë e njëzetë) lekë,pa TVSH**, pikët totale të marra [____],është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”,Sheshi “Kamber Dërmyshi “ ,pranë Njesisë së Prokurimit,kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [____], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.08.2019.

Ankesa: Nuk ka pasur ankesa .

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**KRYETARI
KLODIAN TAÇE**

Konceptoi: E.Guzi

Miratoi: E.Guzi

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____